



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes të jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
01.10.2020, duke filluar në orën 13:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Fadil Gashi, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

Munguan: Egzon Azemi, Vala Peshku, Blerand Stavileci.

Të pranishëm ishin edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit dhe Leutrim Retkoceri.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, kryesuesi tha se para kësaj mbledhjeje të KPF-së e kem thirrur edhe një takim me shefat e GP-ve, ku na ka ftuar drejtoresha e Financave për të diskutuar për këtë çështje dhe kemi dhëna propozimet tona. Tani, pas shqyrtimit të atyre propozimeve dhe sugjerimeve, kemi këtu një dokument të përpunuar, i cili është një shkallë më lart. Ne këtu jemi si KPF, sipas detyrës zyrtare, me shqyrtuar edhe një herë, në mënyrë që ta bëjmë sa më të lehtë edhe për mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

RENDI I DITËS:

1. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2021-2023;
2. Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale në kategoritë "Subvencione dhe transfere" dhe "Mallra dhe shërbime".

Pika e parë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2021-2023;

Valbona Ahmeti - Makolli shprehu falënderim për bashkëpunim të të gjithë atyre që kanë pasur mundësi të ndihmojnë lidhur me këtë propozimbuxhet të vitit 2021.

Para se të fillojë me propozimbuxhetin e vitit 2021, ajo informoi lidhur me çështjen e projekteve të vitit 2020, duke cekur se një pjesë e projekteve janë në procedurë të prokurimit, qoftë në fazë fillestare, qoftë në fazë iniciuese, ku prej 204 projekteve të vitit 2020, në planin e prokurimit vetëm 73 projekte janë të pakontraktuara, ose janë në procedurë fillestare, 8 janë anuluar dhe 123 kontrata janë të nënshkruara përmes Komunës dhe organizatave ekonomike. Po ashtu, ceku se si problem kryesor është se gjysma e këtyre projekteve janë me grantet qeveritare dhe në fund të vitit grantet qeveritare tërhiqen nga Ministria e Financave. Ne së bashku me Asociacionin e Komunave të Kosovës, e kemi ngrit këtë çështje si shumë shqetësuese.

Sa i përket propozimbuxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021, me Qarkoren e fundit, e cila ka pasur shkurtime buxhetore, buxheti për vitin 2021 është 85,792,836 €, në 5 kategori:

“Paga dhe mëditje” - 31 milionë, “Mallra dhe shërbime” - 20 milionë, “Komunali” - 2 milionë e 100 mijë, “Subvencione” - 4 milionë dhe “Kapitale” - 28 milionë e gjysmë.

Granti për vitin e ardhshëm është 18 milionë, grandit i Arsimit është 6 milionë dhe obligimi i Komunës për mbledhjen e të hyrave vetanake është 28 milionë e 271 mijë €.

Atë që kemi bërë këtë vit është se i kemi ndarë përmes drejtorive, mirëpo disa projekte të cilat i kanë kërkuar drejtorët, i kemi qitur në “Mallra dhe shërbime”, ku detajet janë në propozimin e fundit që i ka dërguar Shërbimi i Kuvendit.

Agim Gashi i parashtrroi pyetje drejtoreshës, duke thënë se dokumenti si dokument edhe më herët kështu kishte qenë, titulli i parë është “Buxheti i administratës”, kjo është një vlerë e madhe brenda kësaj radhitje, ka projekte nga shumë drejtori, pse ato nuk janë shpërndarë në kuadër të drejtorive, por janë klasifikuar këtu e pastaj janë ndarë drejtoritë, ku në pozicionet e tyre nuk po shihen këto projekte.

Valbona Ahmeti-Makolli dha përgjigje, duke thënë se nuk e di a është në rregull, por është sipas grantit qeveritar, ku granti qeveritar është i ndarë në tri pjesë: Administratë, Arsim dhe Shëndetësi. Kjo është arsyeja pse i kemi ndarë ashtu.

Agim Gashi tha se shumica e propozimeve që i paraqita në takim ishin inkorporuar.

Valbona Ahmeti - Makolli bëri të ditur se ato kërkesa, përveç ndërtimit të deponisë, që ende nuk kemi mundur me vendosur për shkak të lokacionit, dhe ato të cilat direkt nuk janë përfshirë në buxhet, duhet me qenë te ato dy pikat e investimeve kapitale, që janë infrastrukturë rrugore rurale dhe urbane.

Agim Gashi u shpreh se këtu ka një dallim, te zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, sepse është projekt specifik dhe nuk mund të inkorporohet në kodin buxhetor “ndërtimi i rrugëve rurale”. Po ashtu, tha se ne e kemi në buxhetin e vitit të kaluar afër 40 mijë, apo 50 mijë € në rastin e rishikimit të buxhetit, i kemi ndarë dhe e kemi krijuar kodin për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit. Aty është menduar për projektim, meqenëse edhe ai si projekt, kompania kontraktuese e Komunës nuk e di a merret edhe me ujësjellës, ashtu është menduar, ndërsa

është shkruar "ndërtimi i rrjetit", mirëpo me 50 mijë euro nuk mjaftojnë as me shpallur tenderin, e jo me punuar në atë fushë.

Do të ishte mirë që në buxhetin e vitit 2021 me u paraparë një sasi e mjeteve dhe me u titulluar "Vazhdimi i ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit", se kjo fjalë "e vazhdimit", e nënkupton, e dallon prej vitit paraprak buxhetor. Po ashtu, informoi se një ditë më parë kishte pasur takim me nënkryetarin e Komunës për ujësjellësin, me udhëzim të kryetarit, dhe janë pajtuar që brenda këtyre ditëve ta caktojnë ekipin profesional që do ta hartojë detyrën projektuese për shpalljen e tenderit për hartimin e projektit dhe do t'ia dërgojnë Komunës. Komuna pastaj do ta shpallë tenderin për hartimin e projektit për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit. Kjo është procedurë, pra procedurë profesionale, jo vetëm administrative, dhe ajo do të ndodhë, meqenëse ne tash jemi në aspektin e mirëkuptimit dhe kompetencave ligjore që i kanë dy nivelet, qoftë ai qendror ose lokal, është harmonizuar.

Është mirë që ky buxhet me u rritur më shumë se ai 50 mijë që ekziston, se me 50 mijë nuk mund të shpallim tender. Kjo është arsyeshmëria që po dua ta ngre, andaj ju lutem që ta përkrahim me mirëkuptim projektin se nuk është fjala për ndonjë interes personal.

Sa i përket kodeve buxhetore, siç është: "Ndërtimi i shkollës "7 Shtatori"", "Ndërtimi i Sallës Koncertale", që te emërtimet duhet me i dalluar nga emërtimet e vitit të kaluar, se edhe vitin e kaluar i kemi ndarë mjetet dhe nuk janë shpenzuar, ato janë, do të barten, nuk munden me të njëjtin emër edhe vitin e kaluar edhe këtë vit, por duhet me thënë: "Vazhdimi i ndërtimit të kësaj, ose faza e dytë".

Valbona Ahmeti - Makolli tha se në versionin e fundit e kanë rregulluar, pas konsultimit me juve.

Agim Gashi tha se është mirë në mënyrë procedurale, që të dihet sa kanë qenë vitin e kaluar e sa janë këtë vit për të njëjtin projekt.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se lëshimet teknike i kemi përmirësuar me drejtoritë përkatëse, ndërsa kërkesat që janë bërë për ujësjellësin, unë kam biseduar me Kryetarin dhe më ka thënë se një herë duhet me shkuar vetëm projekti dhe punët që i takojnë Komunës, kur të hynë projekti, me kushtet që i lidhim me marrëveshje, duhet me shkuar me bashkë financim edhe Ujësjellësi i paguan gypat etj., e ne pjesën tonë administrative. D.m.th. për këtë projekt ne duhet me marrë para prej bashkëfinancimeve dhe duhet pasur marrëveshjen sa dhe në çfarë faze.

Jeta Rafuna bëri pyetje lidhur me ndërtimin e sallave të edukatës fizike nëpër shkolla, sepse në disa po shkruan emri i shkollave e në të tjerat jo.

Shpresa Shala u përgjigj në pyetjen e znj. Rafuna, duke thënë se zakonisht është për salla të edukatës fizike që fillohen dhe përfundohen vitin tjetër, me emër nuk i kemi.

Jeta Rafuna pyeti se a ka kaluar tenderi për sallën e edukatës fizike të shkollës "Gjergj Fishta".

Shpresa Shala tha se kjo është në projektet e këtij viti (2020) dhe ende nuk ka kaluar tenderi.

Halim Halimi bëri vërejtje, duke thënë se çdo herë po na vijnë materiale nga 2-3 herë dhe nuk e di sa ka qenë transparente procedura rreth hartimit të buxhetit, por prapë po ju lus që materialet të na i dërgoni me kohë, kontrolloni më herët dhe kur të na i sillen materialet le të na vinë përnjëherë, sepse ne po bazohemi në ato materiale që na kanë ardhur, e materialet që

po vijnë më vonë nuk po kemi kohë me i përcjellë, kështu që keni pasur kohë mjaft me i rregulluar. E keni parasysh se kjo nuk po ndodh vetëm në këtë mbledhje.

Po ashtu, tha se në material shkruan "Renovimi i godinës së zjarrfikësve të "Xhamia e Llapit"", që realisht të "Xhamia e Llapit" nuk ka kurrfarë godine të zjarrfikësve, ndërsa objekti gjendet në lagjen "Kodra e Trimave", andaj kjo të përmirësohet dhe të shkruhet "Renovimi i godinës së zjarrfikësve në lagjen "Kodra e Trimave".

Po ashtu, ceku se në vitin e kaluar ka hyrë vazhdimi i rrugës për Nishevc, d.m.th. Keqekollë - Nishevc, ndërsa këtë vite nuk është.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se kam biseduar me drejtorin, Gëzimin, dhe më ka thënë se ajo është në tender, ka shkuar deri në fund dhe ajo do të kryhet.

Pika e dytë

Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale në kategoritë "Subvencione dhe transfere" dhe "Mallra dhe shërbime".


Valbona Ahmeti - Makolli bëri të ditur se sa i përket fondit rezervë, është hera e parë që na i kanë qitur këto mjete. Këto mjete kanë qenë të parapara për rritjen e pagave, sipas Ligjit të ri të pagave, mirëpo në momentin kur Kushtetuesja e ka rrëzuar atë ligj, secilës komunë ia ka qitur për rezerva, mirëpo e dini si ishte situata, jo rishikimi, jo pakot ekonomike, ne si komuna e kemi ngritur zërin, çka me këto mjete që janë grante qeveritare. E keni vendimin që ua kemi dërguar, ku ministrja e ka lejuar shfrytëzimin e këtyre mjeteve, mirëpo vetëm në kategorinë e pagave dhe mëditjeve jo, aty ku ka nevojë, e ka cekur mirë se është për çështje pandemie. Kryetari e ka paraparë diku mbi 400 mijë e diçka për "mallra dhe shërbime", zakonisht po shkojnë dezinfektues për çështje të përditshme, dhe 2 milionë i ka paraparë me ia shtuar për ndihmë asaj pikës, pakos ekonomike, për firmat të cilat kanë pësuar prej pandemisë. Këto janë pikat të cilat i kemi paraparë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale në kategoritë "Subvencione dhe transfere" dhe "Mallra dhe shërbime" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta**



Faqe 4 nga 4